



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 09 Janar 2023

Nr: 9

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DIBËR, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, ZJ. MALVINA HASAN FIDA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 5249 prot., datë 10.11.2022, këshilli i bashkisë Dibër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Besmir Fatmir Markeçi, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Dibër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 18, zj. Malvina Hasan Fida.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Data: 09 Janar 2023 Nr: 9  
Ora: 11:30



Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Malvina Hasan Fida

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 54 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Malvina Hasan Fida, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 4037 prot., datë 12.12.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 4038 prot., datë 12.12.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Malvina Hasan Fida.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr.12818/1 prot., datë 19.12.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Malvina Hasan Fida, në këshillin e bashkisë Dibër, ku konstatohet se me lidhjen e martesës ka marrë mbiemrin e bashkëshortit duke ndryshuar përbërësit e gjendjes civile nga “Cara” në “Fida”.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 14634/1 prot., datë 19.12.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Malvina Hasan Fida, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Malvina Hasan Fida, në këshillin e bashkisë Dibër nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Malvina Hasan Fida.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre ) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**